REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

Nr.prot 444 Kuçovë, më 18.02.2016

Lënda: Dërgim i buxhetit për vitin 2016.

Drejtuar: Ministrisë së Financave
Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit
Drejtoria e Marrëdhënieve Fiskale Ndërqeveritare
Tiranë

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe të Udhëzimit nr. 2, dt. 06.02.2012, " Për Procedurat Standarde të Zbatimit tw Buxhetit", bashkëlidhur ju dërgojmë buxhetin e Bashkisë Kuçovë për vitin 2016. " dhe formularin nr.14, (për numrin e punonjësve të Bashkisë Kuçovë dhe Institucioneve në varësi).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj,

23-2-2016

Selfo Kapllani

Kryetari i Bashkisë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA KUÇOVË

Buxheti Vendor
Bashkite
2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT BERAT
SEKTORI JURIDIK DHE I FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 169/1 Prot. Berat, më 10.02.2016

Lënda: *Për verifikim të ligjshmërisë së akteve.*

Drejtuar: Bashkisë KUÇOVË

Në mbështetje të nenit 14 të Ligjit nr. 8927 datë 25.07.2002 "Për Prefektin", pasi verifikova bazueshmërinë ligjore të akteve, shprehem:

- Konfirmoj vendimin nr. 1 datë 31.01.2016 të këshillit të bashkisë me objekt: "Mbi miratimin e tematikës së mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Kuçovë për periudhën Shkurt-Qershor 2016."
- Konfirmoj vendimin nr.2 datë 31.01.2016 të këshillit të bashkisë me objekt: " Për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1-31 Janar 2016 për personat me PAK dhe Invalidët e Punës."
- Konfirmoj vendimin nr.3 datë 31.01.2016 të këshillit të bashkisë me objekt: " Për përcaktimin e kritereve,procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike për individët dhe familjet në nevojë me fondin e Bashkisë".
- Konfirmoj vendimin nr.4 datë 31.01.2016 të këshillit të bashkisë me objekt: " Mbi miratimin e shpërndarjes së bursave të arsimit të mesëm për nxënësit sipas tabelës bashkëlidhur vendimit".
- Konfirmoj vendimin nr.5 datë 31.01.2016 të këshillit të bashkisë me objekt: "Mbi miratimin e disa ndryshimeve të vendimit nr.48 datë 9.12.2015 të këshillit bashkiak "Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2016".
- Konfirmoj vendimin nr.6 datë 31.01.2016 të këshillit të bashkisë me objekt: "Mbi buxhetin e bashkisë Kuçovë për vitin 2016 dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve".
- Konfirmoj vendimin nr.7 datë 31.01.2016 të këshillit të bashkisë me objekt: "Mbi kategorizimin e nivelit të pagave të punonjësve të zgjedhur dhe të emëruar".

PREFEKTI I QARKUT

FADIL NASUFI

Adresa : Lagjia " 28 Nentori" *Tel/Fax 032 2 34 141*

Formulari 14

Raportimi i Fondit të pagave dhe Numrit të punonjësve të njësisë së qeverisjes vendore

Emri i njësisë				
Bashkia Kuçovë	**Viti 2015 (fakti)**		**Viti 2016**	
	Numri i punonjësve	**Fondi i pagave (në lekë)**	**Numri i punonjësve**	**Fondi i pagave (në lekë)**
Bashkia Kuçovë dhe Njesite Administrative	137	64,822,861	127	68,000,000
PMNZSH	0	0	13	8,763,550
ADMINISTRIMI I PYJEVE	0	0	1	465,651
UJITJA DHE KULLIMI	0	0	2	1,042,000
Institucionet e varësisë:				
Drejtoria e Kultures	3	1,447,598	9	3,910,000
Agjencia e Shërbimeve Komunale	41	14,105,505	56	21,101,000
Drejtoria Ekonomike e Arsimit dhe sportit	36	12,049,494	161	74,179,538
Çerdhe	23	6,923,082	23	7,290,000
Sektori i sh.Sporteve	5	1,429,062	6	2,700,000
Sektori ekonomik dhe sek ndihmes	5	2,495,019	21	6,800,000
Qendra ditore per femijet me aftesi te kufizuara				
	3	1,202,331	3	1,779,538
Arsimi parashkollor dhe Q,K,F	0	0	98	51,632,000
Sek. Ndihmes Arsimi i mesem				
	0	0	10	3,978,000
Totali	**217**	**92,425,458**	**369**	**177,461,739**

Dr.Financës & Buxhetit
Heroina Shkembi

Kryetari i Bashkisë
Selfo KAPLLANI

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA KUÇOVE

KESHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.06 dt.31/01/.2016

- MBI BUXHETIN E BASHKISE KUÇOVE PER VITIN 2016

- NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE

Këshilli Bashkiak pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Bashkia Kuçove, ne mbeshtetje te nenit 102 te Kushtetutes, te ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne R.SH", te ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 " Per VeteqeverisjenVendore", V.K.M. nr 586 dt.17.07.2013 "Per disa ndryshime ne Vendimin nr. 1619 dt 02.07.2008 te Keshillit te Ministrave "Per klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njesive te Qeverisjes Vendore per efekt page, e per caktimin e kufijve te pagave te punonjesve te organeve te Qeverisjes Vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 9632 date 30.10 2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore " i ndryshuar; miratoi, Buxhetin per vitin 2016 :

•	TE ARDHURAT	VITI; 2015	2016
	BUXHETI I TE ARDHURAVE	**391,682,973**	**425,615,955**
I	Te Ardhurat e Veta	173,838,140	201,200,000
II	Transferte e Pakushtezuar	126,360,000	118,949,858
III	Transferte e kushtezuar	20,296,919	92,466,097
IV	Te Ardhura te trasheguara	71,187,914	13,000,000

I.TOTAL TRANSFERTE E PAKUSHTEZUAR: 118,949,858 Leke

Transferta e pakushtezuar per 2016 eshte miratuar 7,410,142 leke me pak se ne 2015.

II. TOTAL TRANSFERTE E KUSHTEZUAR PER FUNKSIONET SHTESE:

Transferta e kushtezuar per 2016 eshte parashikuar 86,391,550 leke, e ndare si vijon:

- Arsimi parauniversitar: 4,642,000 leke.
- Shpenzime transporti (Arsimi): 6,074,544 lekë
- Arsimi parashkollor dhe punonjesit e sherbimeve mbeshtetese ne arsimin baze: 60,255,000 leke.
- Mbrojtja nga zjarri (PMNZSH): 11,249,150 leke.
- Administrimi pyjor: 613,185 leke.
- Ujitja dhe kullimi: 5,226,677 leke.
- Mbrojtja sociale: 2,477,538 leke.
- Rruget rurale: 1,928,003 leke.
-

II. TE ARDHURAT E TRASHEGUARA NGA VITI 2015

Ne buxhetin e vitit 2016 do te perfshihen te ardhurat e krijuara dhe te paperdorura gjate muajit Dhjetor 2015, gjithsej 13,000,000 leke.

III.TE ARDHURAT E VETA TE VITIT KORRENT

Te Ardhurat e Programuara per Buxhetin e Bashkise nga taksat dhe tarifat vendore per vitin 2016 bazohen ne treguesit baze te te ardhurave te vitit 2015 te te kater Njesive Administrative; Kucove, Kozare, Perondi dhe Lumas, ku jane pasqyruar edhe permirsimet e bera ne zbatim te ligjeve te miratuara kohet e fundit dhe keto te ardhura perbehen :

I.Te ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore te percaktuara me ligjin nr.9632 date 30.10 2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore " te ndryshuar me ligjin Nr. 142/2015, date 17.12.2015, dhe me Vendimin e Keshillit Bashkiak Nr 48, date 09.12.2015 "Mbi Miratimin e Taksave e Tarifave Vendore te vitit 2016".

II. Te ardhurat jo-tatimore te cilat perbehen nga :

- te ardhurat nga tarifat per sherbimet e ndryshme

- te ardhurat nga shitja dhe dhenia me qera

- te ardhura te tjera.

III.Te ardhurat nga institucionet qe jane ne vartesi te Qeverisjes

Vendore .

IV.Te ardhurat nga Agjentet Tatimor .

V.Transferta e pakushtezuar nga Pushteti Qendror .

VI.Transferta e Kushtezuar nga Pushteti Qendror (per funksione qe miratohen ne buxhetin e Njesive te Qeverisjes Vendore).

TE ARDHURAT VITIT 2016

Ne Buxhetin e vitit 2016, te ardhurat e Bashkise jane programuar qe te arketohen nga Taksat dhe Tarifat vendore dhe te te ardhurave te tjera, ne zbatim te ligjit Nr. 9632 ,date 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave e Tarifave Vendore" te ndryshuar, me ligjin Nr. 142/2015, date 17.12.2015, si dhe te Vendimit te Keshillit Bashkiak nr 48, date 09.12.2015 "Mbi Miratimin e Taksave e Tarifave Vendore te vitit 2016.

Te ardhurat per vitin 2016 jane planifikuar qe te realizohen ne vleren 201 200 000 leke dhe sipas njesive administrative jane:

Njesia Administrative	Vlera/leke	%
Kuçove	100 770 000	50
Kozare	38 580 000	19
Perondi	34 470 000	17
Lumas	27 800 000	14
Totali	201 200 000	100

Treguesit kryesore te programuar per vitin 2016, te ketyre te ardhurave, do ti analizojme me poshte, duke mbajtur parasysh se drejtimet kryesore ku do te mbeshtesim realizimin e te ardhurave te ketij viti do te jene:

- Zgjerimi i bazes se Taksueshme
- Evidentimi, licensimi dhe derdhja e detyrimeve nga te gjithe subjektet qe zhvillojne aktivitet.
- Ndjekja ne vazhdimesi e arketimit te te ardhurave nga debitoret.
- Arketimi i detyrimeve ne afatin e percaktuar ne zbatim te ligjeve dhe vendimeve perkatese.
- Barazi e plote per te gjithe taksapaguesit sipas aktivitetit dhe sherbimit qe i kryhet.
-

A. TE ARDHURAT NGA TAKSAT

I.TAKSA MBI BIZNESIN E VOGEL

Te ardhurat nga taksa mbi biznesin e vogel,ne zbatim te ligjit Nr. 9632 date 30.10.2006 te ndryshuar me ligjin Nr. 142/2015, date 17.12.2015 ze nje perqindje fare te vogel, per shkak te ndryshimit nga ligji i mesiperm, ku subjektet e biznesit te vogel me xhiro nga 0 – 5 milion leke ne vite, te cilet zene mbi 90 % te numrit te pergjithshem te subjekteve te biznesit te vogel dhe paguanin mesatarisht nga 25 000 leke deri ne 40 000 leke ne vite, per vitin 2016 do te paguajne 0 leke ne vite, kurse per subjektet me xhiro 5 deri 8 milion, shkalla tatimore e aplikueshme ulet dhe keto subjekte do te paguajne tatimin, jo 7.5 %, por 5 % mbi fitimin e tatueshem.

II . TAKSE TABELE

Te ardhura nga kjo takse per vitin 2016 nuk jane planifikuar per shkak te zbatimit te ligjit te miratuar nr. 142/2015, date 17.12.2015 ne te cilin theksohet se "per tabelat per qellime identifikimi, deri ne 2 metra katrore te trupezuara ne siperfaqen e nderteses".., taksa e tabeles eshte 0 leke ne vite, si dhe duke u bazuar edhe ne verifikimin konkret ne teren ku rezulton se tabelat ne funksion te aktivitetit te biznesit jane me pak se dy metra katrore.

III TAKSA MBI PASURINE

Te ardhurat e planifikuara nga kjo takse ne zbatim te ligjit do te perbehen nga :

1.Taksa mbi ndertesat

2.Taksa mbi token bujqesore

3.Taksa mbi truallin

1 . TAKSA MBI NDERTESAT

Te ardhurat nga taksa mbi ndertesat, per vitin 2016 jane planifikuar 22 000 000 leke, si me poshte, ne mije leke :

Ne mije leke

TE ARDHURAT	KUCOVE	KOZARE	PERONDI	LUMAS	TOTALI
T.NDERTESE	14990	2520	3070	1420	**22000**

Planifikimi i ketyre te ardhurave sipas taksapaguesve paraqitet:

- Popullata 9 920

- Biznesi	11 390
- Nd /Inst.	690
Shuma	22 000

Planifikimi i te ardhurave nga taksa e nderteses bazohet ne siperfaqen faktike te nderteses ne meter katror per cdo ndertese banimi per familjaret dhe per cdo biznes dhe ne taksen perkatese, ne zbatim te ligjit nr. 142/2015, date 17.12.2015. Per nje evidentim me te sakte te te gjitha siperfaqeve per cdo ndertese ne te gjithe bashkine, eshte ngritur grupi i punes i cili do te funksionoje deri ne perfundimin me efektivitet te ketij procesi.

Duke u bazuar ne rezultatet e mira ne arketimin e tarifave vendore te pastrimit, ndricimit dhe gjelberimit, si rezultat i futjes se ketyre tarifave ne faturen e Ujesjellesit, per vitin 2016, do te negociohet dhe do te rritet angazhimi me qellim qe te futet ne kete fature edhe taksa e nderteses per ndertesat e banimit te familjareve, per arketimin e te ardhurave te saj per vitin 2016 si dhe te detyrimit te prapambetur.

2.TAKSA MBI TOKEN BUJQESORE

Te ardhurat nga kjo takse per vitin 2016 do te realizohet ne tre njesite vendore ne te cilat shtrihet siperfaqja e tokes bujqesore duke u bazuar ne siperfaqen e saj dhe ne tatimin perkates sipas kategorise se tokes, duke rritur per vitin 2016 bazen e taksueshme te saj nepermjet evidentimit dhe regjistrimit real te tokes bujqesore dhe keto te ardhura sipas njesive administrative do te jene:

Ne mije leke

TE ARDHURAT	KUCOVE	KOZARE	PERONDI	LUMAS	TOTALI
TATIM TOKE		5 800	8 800	4 400	**19 000**

3.TAKSA MBI TRUALLIN

Te ardhurat nga taksa mbi truallin (jo hapesire publike), programohen per here te pare ne te ardhurat vendore te bashkise, ne zbatim te ligjit nr.142/2015 te miratuar ne date 17.12.2015 dhe per vitin 2016 jane planifikuar ne vleren 2 200 000 leke. Baza e takses mbi truallin eshte siperfaqja e truallit, ne meter katror, ne pronesi apo perdorim te taksapaguesit, per te cilen gjate vitit 2016, mbi bazen e nje programi pune do te evidentohet e gjithe siperfaqja e truallit ne juridiksion te bashkise dhe bazuar ne vleren 0.42 leke/m2/vite per qellime banimi dhe 18 leke/m2/vite per qellime biznesi do te permirsojme treguesit per te rritur te ardhurat nga kjo takse.

IV. TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE

NGA LEJET E NDERTIMIT

Te ardhurat nga taksa e ndikimit ne infrastrukture e cila perbehet nga Lejet e Ndertimit, do te realizohen ne zbatim te ligjit nr.9632 date 30.10 2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore " te ndryshuar me ligjin Nr. 142/2015, date 17.12.2015, neni 27. Per vitin 2015 ishin planifikuar

4 200 000 leke, kurse per vitin 2016 keto te ardhura jane programuar 6 500 000 leke ose 2 300 000 leke me shume se plani i vitit 2015, duke u bazuar ne kerkesat e vitit 2016 per lejet e reja te ndertimit per te ardhmen, dhe sipas njesive vendore paraqiten :

Ne mije leke

TE ARDHURAT	KUCOVE	KOZARE	PERONDI	LUMAS	TOTALI
T.NDIK.INFRASTRU.	3 600	1 500	1 000	400	6 500

V. TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE

NGA LEGALIZIMET

Per vitin 2016 te ardhurat nga kjo takse jane programuar 24 000 000 leke, ose 20 500 000 leke me shume se plani i vitit 2015, megjithese kete vit nuk u realizuan per shkak te procedurave te zbatuara nga Aluizni. Per vitin 2016 keto te ardhura jane programuar qe te realizohen, pasi sipas te dhenave, kane perfunduar perllogaritjet e shume dosjeve te objekteve per legalizim ku sipas njesive administrative jane planifikuar :

Ne mije leke

TE ARDHURAT	KUCOVE	KOZARE	PERONDI	LUMAS	TOTALI
TARIFA E NDIK.INFRA.LEGAL	15 000	3 000	3 600	2 400	24 000

VI. TAKSA E AUTOMJETEVE TË PËRDORURA

Kjo takse,ne zbatim te ligjit nr.9632 date 30.10.2006, vilet nga strukturat e DPSHTRR-Berat dhe te ardhurat nga kjo takse derdhen ne favor te Bashkise ku ne zbatim te ketij ligji Bashkia perfiton 94 % te shumes se arketuar.

Niveli i te Ardhurave te programuara nga kjo takse per vitin 2016, bazuar ne ecurine e arketimit te kesaj takse ne vitet e fundit, do te jene ne masen 8 000 000 leke.

B. TE ARDHURAT NGA TARIFAT

I. TARIFA PER ZENIEN E HAPESIRES PUBLIKE

Ne zbatim te ligjit nr.9632 date 30.10.2006, neni 32 te ndryshuar me ligjin nr. 142/2015, date 17.12.2015, kjo tarife, e cila me pare quhej "takse" eshte percaktuar qe niveli i kesaj tarife per njesine administrative Kucove te jete 60 leke/m2/muaj, kurse per njesite e tjera administrative niveli i saj te jete 30 leke/m2/muaj.

Per vitin 2016, nga tarifa e zenies se hapesires publike jane programuar te ardhura, me vleren 3 500 000 leke, duke u bazuar ne rritjen e bazes se taksueshme, dhe lidhjen e kontrates me subjektet per zenien hapesires publike dhe pagesen e saj qe ne fillim te vitit dhe sipas njesive administrative jane planifikuar :

Ne mije leke

TE ARDHURAT	KUCOVE	KOZARE	PERONDI	LUMAS	TOTALI
T.ZENIE HAP.PUBLI biznesi	2650	280	400	170	3500

II. TARIFA E LENIES SE MALLIT NE TREGUN E PERQENDRUAR NE KUCOVE

Tarifa e Lenies se mallit ne Tregun e Perqendruar ne Kucove nga tregetaret qe ushtrojne aktivitetin e tyre ne kete treg, sipas miratimit te bere ne Paketen Fiskale per vitin 2016 do te mbetet ajo e vitit 2015 , me 500 leke ne muaj per tregetar, per rrjedhoje edhe per vitin 2016, e ardhura nga kjo tarife eshte planifikuar ne masen 1 000 000 leke.

III. TARIFA PER THERJEN E BAGETIVE

Per vitin 2016 mbeshtetur ne Paketen Fiskale , ne te cilen nuk jane bere ndryshime te nivelit te kesaj tarife, te ardhurat nga ky ze parashikohen 300 000 leke, ose 60 000 leke me shume se sa ishin planifikuar ne vitin 2015.

IV. TARIFAT E TREGUT

Per vitin 2016 parashikojme qe te Ardhurat nga Taksa e Tregut te jene 8 480 000 leke sipas ndarjes se meposhtme :

- Tregu i Perqendruar 6 500 000 leke,
- Tregu ditor 1 980 000 leke.

Te ardhurat nga Tregu i Perqendruar per vitin 2016 jane planifikuar me vleren 6 500 000 leke, duke u bazuar ne numrin e bokseve si ne vitin 2015, kurse te ardhurat nga tregu i lire ditor 1 980 000 leke, nga te cilat 1 800 000 ne Kucove dhe 180 000 leke ne Lumas.

V. TARIFA PER LEJET E TRANSPORTIT

Keto te ardhura sigurohen nga mjetet e Transportit Mall dhe Taksi te cilet pajisen me Leje Transporti prane Drejtorise se Sherbimeve Publike ne Bashki. Per vitin 2016 jane programuar 640 000 leke.

7.TARIFA E PASTRIMIT

Per vitin 2016 te ardhurat nga kjo tarife jane programuar qe te jene 19 360 000 leke dhe sipas njesive administrative jane planifikuar si me poshte :

Ne mije leke

TE ARDHURAT	KUCOVE	KOZARE	PERONDI	LUMAS	TOTALI
T.PASTRIMI	15850	1370	1840	300	19360

Planifikimi i ketyre te ardhurave sipas taksapaguesve paraqitet:

1. Nd/ Institucionet 2 000 000 leke
2. Popullata 7 270 000 leke
3. Biznesi i madh 1 580 000 leke

4.Biznesi i vogel 8 510 000 leke

TOTALI 19 360 000 leke

Realizimi i te ardhurave nga kjo tarife do te arrihet nepermjet rritjes se bazes se taksueshme nga te gjithe taksapaguesit e kesaj tarife dhe miratimit te tarifave te perafruara me koston, ne zbatim te vendimit perkates te Keshillit Bashkiak, te miratuar per paketen fiskale te vitit 2016, duke mbajtur ne qender te vemendjes rritjen dhe permirsimin e ketij sherbimi ndaj komunitetit.

8 -TARIFA PER MJEDISIN DHE GJELBERIMIN

Per vitin 2016 te ardhurat nga kjo tarife jane programuar qe te jene 4 500 000 leke, e cila e krahasuar me planin e vitit 2015 jane 260 000 leke me shume, ku sipas njesive administrative jane planifikuar si me poshte:

Ne mije leke

TE ARDHURAT	KUCOVE	KOZARE	PERONDI	LUMAS	TOTALI
T.GJELBERIMI	4500	0	0	0	4500

Planifikimi i ketyre te ardhurave sipas taksapaguesve paraqitet:

1.Popullata 2 500 000 leke

2.Biznesi i madh 210 000 leke

3.Biznesi i vogel 870 000 leke

4.Nd/ Institucionet 920 000 leke

TOTALI 4 500 000 leke

9- TARIFA E NDRICIMIT RRUGOR

Per vitin 2016 te ardhurat nga kjo tarife jane programuar qe te jene 7 100 000 leke, te cilat te krahesuara me vitin 2015, jane 864 000 leke me te larta, ku sipas njesive administrative jane planifikuar si me poshte:

Ne mije leke

TE ARDHURAT	KUCOVE	KOZARE	PERONDI	LUMAS	TOTALI
T.NDRICIMI RRUGOR	6200	290	610	0	7100

Planifikimi i ketyre te ardhurave sipas taksapaguesve paraqitet:

1.Popullata 5 250 000 leke

2.Biznesi i madh 280 000 leke

3.Biznesi i vogel 1 370 000 leke

4.Nd/ Institucionet 200 000 leke

TOTALI 7 100 000 leke

Ndryshimet e pasqyruara ne tabelat e mesiperme, te programit te vitit 2016 per tarifat e gjelberimit dhe te ndricimit, ne krahasim me vitin 2015 argumentohen me te njejten analize te bere per te ardhurat nga tarifa e pastrimit te theksuar me larte.

10.TARIFA MBI UJIN E PIJSHEM

Te ardhurat qe do te realizohen per vitin 2016 per ujin e pijshem bazohen ne tarifat e aplikuara ne vitin 2015 si dhe ne nje administrim me te mire per kete vit duke u planifikuar ne vleren 8 700 000 leke, nga te cilat 5 500 000 leke ne njesine vendore Kozare dhe 3 200 000 leke ne njesine vendore Lumas.

11.TARIFA MBI LENDEN DRUSORE

Te ardhurat qe do te realizohen per vitin 2016 per lenden drusore bazohen ne tarifat e aplikuara ne vitin 2015, duke u planifikuar ne vleren 2 100 000 leke.

12 -TARIFA PER SHERBIME

Keto te ardhura vijne nga tarifat e sherbimeve te ndryshme ne Bashki per vertetime, leje te ndryshme, etj. Per vitin 2016 jane programuar qe keto te ardhura te jene 630 000 leke, te cilat bazohen ne tarifat e sherbimeve qe do te kryhen nga te kater njesite vendore, sipas miratimit te bere ne Paketen Fiskale per vitin 2016 dhe sipas njesive administrative jane planifikuar :

Ne mije leke

TE ARDHURAT	KUCOVE	KOZARE	PERONDI	LUMAS	TOTALI
TARIFA SHERBIMESH	300	150	150	30	630

C. TE ARDHURA TE TJERA

1. TE ARDHURA NGA QERATE

Per vitin 2016 te ardhurat nga qerate jane planifikuar ne vleren 10 460 000 leke te cilat bazohen ne kontratat e lidhura me subjektet perkatese ne zbatim te ligjeve specifike te tyre dhe perbehen :

a.Qera nga objektet e sipermarrjeve 1 040 000 leke

b.Qera nga apartamentet 1 300 000 leke

c.Qera nga toka bujqesore 3 620 000 leke

d.Qera nga toka pyjore 4 500 000 leke

Shuma 10 460 000 leke

Keto te ardhura sipas njesive administrative jane planifikuar :

Ne mije leke

TE ARDHURAT	KUCOVE	KOZARE	PERONDI	LUMAS	TOTALI
QERA APARTAMENTI	1 300				**1 300**
QERA OBJEK,SIP	1 040				**1 040**
QERA TOKA BUJQESORE		1 000	1 500	1 120	**3 620**
QERA TOKA PYJORE		3 000	750	750	**4 500**

2.TE ARDHURA NGA KOPSHTET DHE ÇERDHET

Te ardhurat nga kopshtet dhe cerdhet jane planifikuar duke pare ritmin dhe te dhenat mbi frekuentimin e kopshteve dhe te çerdheve nga femijet (te dhena nga Qendra e Llogarise Arsimit) si dhe faktin e vitit 2015, te cilat edhe per vitin 2016 te ardhurat gjithsej nga kopshtet dhe çerdhet, planifikohen te jene ne nivelin e vitit 2015 :

Nga Kopshtet 3 000 000 leke.

Nga Çerdhet 2 000 000 leke

2. TE ARDHURA NGA DEBITORET

Ne planin e te ardhurave te vitit 2016, te ardhurat nga debitoret zene nje peshe te konsiderueshme me vleren totale per 42 000 000 leke te cilet perbehen nga debitoret per tatimin e tokes, tatimin e pasurise, tatimin mbi biznesin, etj. Per te gjithe keta debitore per vitin 2016; Bashkia do te hartoje nje plan masash te detajuar per te gjitha strukturat qe lidhen dhe kane pergjegjesi per vjeljen e te gjitha detyrimeve te prapambetura te debitoreve, duke zbatuar te gjitha procedurat ligjore.

Miratimi ne daten 17 dhjetor 2015 i ligjit 142/2015 dhe ndryshimi i disa taksave,si taksa e tabeles, taksa mbi truallin, taksa e ndikimit ne infrastrukture, taksa per hapesiren publike etj., shtrojne nevojen dhe detyren per studime dhe analiza gjate vitit 2016, per aplikimin dhe zbatimin konkret te ketyre taksave me objektivin e arketimit dhe rritjes se te ardhurave te bashkise per te ardhmen.

Ne planifikimin e te ardhurave per vitin 2016 ne krahesim me vitin e kaluar, kane gjetur dhe do te gjejne zbatim ne te ardhmen, ndryshimet e ligjeve te miratuara gjate vitit 2015, si edhe miratimi dhe zbatimi paketes fiskale te vitit 2016 dhe i ligjit nr 142/2015, te dates 17.12.2015, te cilet kane ndikuar ne permiresimin e klimes se biznesit duke ulur taksat dhe tatimet e tyre, por ne te njeten kohe kane ulur edhe te ardhurat e planifikuara te Bashkise.

Peshen kryesore ne kete ulje per bashkine tone e kane :

1.Tatimi i thjeshtuar i fitimit mbi biznesin e vogel me 20 910 000 leke

2.Taksa e nderteses per Albpetrol sha me 5 557 000 leke

3.Taksa e tabeles me 127 000 leke

Shuma 26 594 000 leke

Me keto kushte plani i vitit 2015 do te ishte 171 469 000 - 26 594 000 = 144 875 000 leke.

Nga te dhenat analitike te paraqitura me siper, sipas treguesve dhe ndryshimeve te reflektuara ne perllogaritjen e te ardhurave, bazuar edhe ne miratimin e Paketes Fiskale te Vitit 2016, rezulton se te ardhurat e planifikuara nga burimet e veta te Bashkise te jene ne masen 201 200 000 leke, ose 56 325 000 leke me shume se plani i vitit 2015, (i korektuar). Peshen kryesore ne kete rritje e zene te ardhurat nga :

- taksa e nderteses 8 310 000 leke
- tatimi i tokes 5 335 000 leke
- tarifa e zenies se hapesires publike 1 910 000 leke
- tarifat pastrim, ndricim, gjelberim nga popullata dhe biznesi 1 421 000 leke
- tarifa nga legalizimet 24 000 000 leke
- arketimet nga debitoret 13 847 000 leke

Realizimi i te ardhurave per vitin 2016 do te shoqerohet me nje angazhim dhe pergjegjesi maksimale nga te gjitha strukturat e Bashkise, per vjeljen dhe arketimin e tyre dhe per ti perdoruar ato per te rritur, realizuar dhe permirsuar te gjitha investimet, sherbimet dhe detyrimet qe kemi ndaj komunitetit te te kater njesive administrative te Bashkise.

SHPENZIMET

Në krahun e shpenzimeve është mirëparë një alokim sa më efiçent i fondeve në dispozicion, duke pasur si objektiv maksimizimin e impaktit që ka buxheti lokal në jetën e qytetit. Gjithashtu në bazë edhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave, shpenzimet edhe për këtë vit, në buxhet janë miratuar në bazë programi.

SHPENZIMET PER FUNKSIONET E VETA

I. *Programi 01110 Administrata Vendore*

Ky program parashikon menaxhimin financiar të Bashkisë dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për funksionimin sa më normal të administratës vendore.

Politika e programit synon të ofrojë mbështetje, zhvillim asistencë teknike dhe financiare ndaj komunitetit nëpërmjet një administrate profesionale.

Qëllimet dhe objektivat e politikës së këtij programi konsistojnë në:

*Modernizimin e shërbimeve të ofruara, me qëllim që të përmirësohet shërbimi ndaj komunitetit.

*Krijimin e një administrate profesionale, të aftë të përballojë sfidat gjithpërfshirëse të integrimit, nëpërmjet sigurimit të kushteve të nevojshme .

*Përmirësimin e menaxhimit dhe përdorimit me efiçencë të fondeve në dispozicion.

*Administrim me efiçencë dhe efektivitet të sistemit tatimor si dhe përmirësimin e infrastrukturës tregtare.

*Përmirësim të menaxhimit urban nëpërmjet planifikimit urban sipas kuadrit ligjor ekzistues.

*Evidentimi dhe përkrahja e familjeve në varfëri të skajshme.

Produktet që synohen të ofrohen:

-Ofrimi i shërbimeve ndaj qytetarëve brënda një kohe të shpejtë.

Staf i trainur nëpërmjet Work-Shop të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit.

-Programe buxhetore afatmesme dhe vjetore për një administrim të mirë ekonomiko financiar të Njësisë .

-Ulje të informalitetit në fushën e biznesit.

Shpenzimet për këtë program paraqiten si më poshtë:

Emertimi i Shpenzimit	**Leke**
Shpenzime për paga	**68,000,000**
Sigurime Shoqërore&Shëndetsore	**11,000,000**
Shpenzime operative	**25,750,072**
Mallra dhe Shërbime	*20,023,592*
Këshilltaret, Kryepleqtë	5,726,480
Shpenzime transporti(Arsimi)	**6,074,544**
Investime (projekte)	**7,000.000**
Investime(pajisje zyre...)	**1,500.000**
Transferta tek institucione	**4,050,000**
Transferta tek individë	**2,380,000**
Fond rezervë	**1,000,000**
Fond emergjence	**1,500,000**
TOTALI	**128,254, 616**

Shpenzimet operative të detajuara sipas zërave, për vitin 2016, parashikohen si vijon:

	EMERTIMI	**Plani i Vitit 2016**
602	**MALLRA DHE SHERBIME**	**25,750,072**
	Materiale zyre dhe të përgjithshme	**1,670,000**
6020100	Kancelari	500,000
6020200	Mat. për pastrim,dezinfektim,ngrohje dhe ndriçim	350,000
6020300	Mat.për funksionimin e pajisjeve të zyrës	580,000
6020500	Blerje dokumentacioni	120,000
6020900	Furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgj.	120,000
6021	**Materiale dhe shërbime speciale**	**270,000**
6021001	Uniforma dhe veshje të tjera speciale	150,000
6021006	Pajisje për përdorim policor	20,000
6021007	Libra dhe publikime profesionale	20,000
6021099	Të tjera materiale dhe shpenzime speciale	80,000
6022	**Shërbime nga të tretë**	

		1,895,000
6022002	Ujë	390,000
6022003	Telefon dhe faks	500,000
6022003	Internet	525,000
6022004	Posta dhe shërbimi korrier	240,000
6022010	Shërbime të printimit dhe publikimit	100,000
6022099	Shpenzime të tjera,mirëmbajtje eeb	140,000
6023	**Shpenzime Transporti**	**2,020,000**
6023100	Karburant dhe vaj	1,600,000
6023200	Pjesë këmbimi,goma dhe bateri	200,000
6023300	Shpenzimet e siguracionit të mjeteve të transportit	100,000
6023300	Shpenzime të tjera transporti	120,000
6024	**Shpenzime udhëtimi**	**800,000**
6024100	Shpenzime Dieta brenda vendit	400,000
6024200	Shpenzime Dieta jashtë vendit	400,000
6025	**Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme**	**636,000**
6025300	Shp. Mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore	200,000
6025600	Shp.mirëmb. e pajisjeve të zyrës	86,000
6025800	Shp.mirëmb. e programit FAIS-TAIS	350,000
6029	**Shpenzime të tjera operative**	**18,256,232**
6029003	Shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore	1,100,000
6029001	Shpenzime për pritje e përcjellje	150,000
6029003	Shpenzime gjyqësore	150,000
6029006	Shp. për anetarët e kësh.bashkiak	3,445,000
6029005	Shp. kryepleqtë	2,241,480
6029006	Pagesa Komisoni AD-HOC	350,000
6029099	Shpenzime për këshilltarët	40,000
6029099	Shp. për të tjera materiale dhe shp. operative	460,000
6029099	Shp. për regj. e pronave të Bashkisë	250,000
6029099	Shpenzime për kampin veror të fëmijëve	70,000

6029099	Shpenzime për ekspertë për shpronësimet	100,000
6029099	Shpenzime për shponësime toke, ndërtese	8,799,752
6029099	Bonus strehimi	600,000
6029099	Kuote anetaresimi	500,000
	Detyrime të prapambetura	**202,840**
6023	Karburant(Nj.A Lumas)	55,000
602	Marrje e makinës me qera (Nj.A Lumas)	147,840
230	Shp. Për përgatitjen e projekteve për investime	**7,000,000**
231	**Investime për materiale zyre dhe të përgjithshme**	**1,500,000**

Në shpenzimet operative të Bashkisë janë parashikuar edhe shpenzimet për tre Njësitë Administrative. Niveli i shpenzimeve është planifikuar mbi faktin e vitit 2015.

Krahasuar me vitin e mëparshëm në këtë zë janë shtuar:

- **Shpenzime transporti për Arsimin: 6,074,544 lekë.**
- Detyrimet e prapambetura nga Njesitë Administrative për vendime gjyqësore në vlerën 1,100,000 lekë.
- shpenzimet për pergatitjen e projekteve per investime ne vleren 7 mln leke,
- shpenzimet per bonus strehimi, në vlerën 600 mijë lekë, të cilat do të përdoren konformë ligjeve dhe udhëzimeve të posaçme,
- shpenzimet për shpronësimet e familjeve të dëmtuara nga ndërtimi i rrugës "Naftëtari" dhe " Kristaq Laçka", në vlerën 8,799,752 lekë.
- shpenzime për kampin veror të fëmijëve në vlerën 70 mijë lekë. Që prej 5 vjetësh është bërë traditë organizimi i Kampit Veror me femijët në nevojë/rrezik, me të cilët punon Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve me mbështetjen e organizatës Save the Children.

Për vitin 2016, ne nuk do ta kemi mbështetjen e organizatës, pasi projekti është mbyllur në Dhjetor 2015.

- shpenzimet për mirëmbajtjen e programit FAIS-TAIS, në vlerën 350 mijë lekë, i cili është program financiar i posaçëm për të ardhurat vendore dhe kontabilitetin financiar, ky program është financuar prej dy vjetësh nga USAID, financimi i tij ka përfunduar në muajin Dhjetor 2015.

Shpenzime Personeli:

Në formë të përmbledhur shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, jepen sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

Njësitë shpenzuese	Viti 2016		
	Nr.Punonjësve	Paga	Sigurime shoqërore
Aparati i Bashkisë+Nj.A	**127**	**68,000,000**	**11,000,000**
Drejtoria Ekonomike e Arsimit	**161**	**74,179,538**	**12,492,000**
Çerdhe	23	7,290,000	1,220,000
Sektori i sh.Sporteve	6	2,700,000	485,000
Sektori ekonomik dhe sek ndihmes	21	6,800,000	1,200,000
Qendra ditore per femijet me aftesi te kufizuara	3	1,779,538	300,000
Arsimi parashkollor dhe Q.K.F	98	51,632,000	8,623,000
Sek. Ndihmes Arsimi i mesem			

	10	3,978,000	664,000
Drejtoria e Kulturës	9	3,910,000	660,000
Agjencia e Shërbimeve Komunale	56	21,101,000	3,552,000
Sek. i Shërbimeve Komunale	34	13,150,000	2,200,000
Sek. i Gjelberimit	16	5,521,000	950,000
Ujësjellësi	8	2,430,000	402,000
PMNZSH	13	8,763,550	1,479,000
ADMINISTRIMI I PYJEVE	1	465,651	77,767
UJITJA DHE KULLIMI	2	1,042,000	190,210
TOTALI	369	177,461,739	29,450,977

Numri i punonjësve është rritur për shkak të funksioneve shtesë, konkretisht; me 1 punonjës të Shërbimit Pyjor, 13 punonjës të PMNZSH, me 2 punonjës Ujitja dhe Kullimi dhe 108 punonjës Arsimi parashkollor dhe sektori ndihmës i Arsimit parauniversitar.

Në numrin e punonjësve të Bashkisë, përfshihet administrata e Bashkisë, Njësive Administrative, agjencia e të ardhurave vendore dhe 5 punonjësit e zyrave të gjendjes civile në bashki e njësi administrative.

Agjencia e shërbimeve komunale ka një rritje me 8 punonjës për ujësjellësin Kozare (aq sa në vitin 2015 për këtë sektor), pranë kësaj strukture janë transferuar edhe punonjësit e mirëmbajtjes së Njësive Administrative. Rritja e numrit të punonjësve pranë kësaj strukture vjen vetëm për shkak të transferimit të punonjësve ekzistues nga Bashkia.

Sektori i Qëndrës Rinore në vitin 2015, ka qenë pjesë e administratës së Bashkisë Kuçovë, për vitin 2016 kjo strukturë është përfshirë në Drejtorinë e Kulturës.

PER KESHILLTARET

Shpenzimet për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Bashkiak, janë përcaktuar sipas VKM nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore ..." i cili përcakton shpërblimin mujor të këshilltarëve në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë.

Fondi i planifikuar si kompensim për keshilltaret është 3.445.000 lekë, shpërblimi për anëtarët e Këshillit Bashkiak do të jetë 10% e pagës së Kryetarit të Bashkisë.

Shpenzimet për shpërblimin e kryepleqve do të jenë 2,241,480 lekë në masën 7 % të pagës së Administratorit të Njësisë Vendore.

TRANSFERIME KESHILLIT TE QARKUT

- Në zbatim të ligjit 8652 datë 31.7.2000, planifikojmë që Këshillit të Qarkut t'i transferohen nga të ardhurat e Bashkisë kuotc anëtarësie (3% e të ardhurave të planifikuara), në shumën **3.190.000** lekë.
- Transferime agjentit tatimor Drejtorise Rajonale Tatimore për vjeljen e të ardhurave nga biznesi i vogël në masën 1% të shumës së arkëtuar, parashikohen **150,000** lekë.
- Transferime agjentit tatimor, U.K.B.K për arkëtimin e tarifave nga familjet në masën 2.5% të shumës së arketuar, parashikohen **560,000** lekë.
- Transferime agjentit tatimor, Posta **150,000** lekë.

TRANSFERIME TE TJERA

Në mbështetje të ligjit 9355 datë 10.03.2005 kreu VI neni 33 mbi "Financimet e programit të ndihmës ekonomike" kemi programuar një fond prej **1,800.000** lekë në buxhetin e këtij viti, për trajtimin e disa rasteve të veçanta, të cilat për arsye ligjore nuk mund të përfitojnë ndihmën ekonomike nga fondi i qeverisë, por që nga gjykimi dhe evindentimi që u është bërë këtyre familjeve nga administratorët shoqërore, duhet të përfitojnë. Kjo

shifër, krahasuar me vitin 2015 ka një rritje prej 350,000 lekësh. Bashkia Kuçovë ka mbështetur për vitin 2015 rreth 40 individë/familje në nevojë/rrezik. Masa e pagesës ka qenë 50% e shumës që do të përfitonin ne skemën e NE me buxhetin e shtetit, duke shfrytëzuar fondin në dispozicion, i cili për vitin 2015 ka qenë 1.200.000 lekë.

Shpenzime për Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve për pagesat e kopshteve e çerdheve për fëmijë në rrisk nga 180,000 lekë në vitin 2015, parashikohen **200,000** lekë. Ky fond do të shërbejë për të mbështetur fëmijë nga familje shumë në nevojë dhe me problematika sociale me pagesën e çerdhes/kopshtit. Me këtë nismë ne duam që të nxisim/fuqizojmë prindrit e tyre që të punojnë dhe të kenë një vend të sigurtë për të lënë fëmijët. Mbështetja do të bazohet në vlerësimin e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve për çdo rast.

- Shpërblim për pension pleqërie **130,000** lekë.
- Transferta të tjera **250,000** (detyrime nga viti 2015, ndihmë sociale për rast fatkeqsie detyrim nga Njësia Administrative Perondi).
- **FONDI REZERVE**

Në bazë të nenit 6 të ligjit 8399 datë 9.9.1998 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7776 datë 22.12.1993 "Për buxhetin vendor", krijohet fondi rezervë në masën jo më shumë se 3% të totalit të shpenzimeve të miratuara, i cili përdoret për të përballuar shpenzimet e paparashikuara në buxhetin vëndor.
Për këtë vit fondi rezervë parashikohet **1,000,000 lekë.**

FONDI I EMERGJENCES

Në bazë të nenit 16 pika 2ç të ligjit nr. 8756, datë 26.03.2002 " Për emergjencat civile" kemi parashikuar fondin prej **1,500.000 lekë,** fond i parashikuar për raste emergjence nga fatkeqësi natyrore e fatkeqësi të tjera.

ADMINISTRIMI I PYJEVE (Programi 04260)

Emertimi i Shpenzimeve	Leke
Paga	465,651
Sigurime	77,767
Mallra e Sherbime	69,767
TOTALI	**613,185**

UJITJA DHE KULLIMI (Programi 04240)

Emertimi i Shpenzimeve	Leke
Paga	1,042,000
Sigurime	190,210
Mallra e Sherbime	1,544,467
INVESTIME	2,450,000

Është program shtesë, i cili do të financohet nga transferta e kushtëzuar.

MBROJTJA NGA ZJARRI DHE SHPETIMI (Programi 10910)

Emertimi i Shpenzimeve	Leke
Paga	8,763,550
Sigurime	1,479,000
Mallra e Shërbime	1,006,600
TOTALI	**11,429,150**

ANALIZA E SHPENZIMEVE PER VITIN 2016

ANALIZA	EMERTIMI I SHPENZIMEVE	SHUMA
